



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 shkurt 2022
Nr.ref.:RK 1942/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI91/21

Parashtrues

Bekim Haxhibeqiri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
PML. nr. 133/2020 të 18 dhjetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bekim Haxhibeqiri me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [PML. nr. 133/2020] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 18 dhjetorit 2020 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e Gjykatës Supreme e ka pranuar më 20 janar 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 14 maj 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani, anëtarë.
8. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21 u konfirmua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të

Rregullores së punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 25 maj 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, i dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
11. Më 25 maj 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore në Gjakovë, përmes të cilës e njoftoi për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë fletëkthesën, përmes së cilës vërtetohet se kur e ka pranuar parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.
12. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KSH. KI91/21, për zëvendësimin e gjyqtarit në kolegji shqyrtues, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha anëtar në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
13. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 për zëvendësimin e gjyqtarëve kryesues në kolegje shqyrtuese, caktoi Kryetaren e zgjedhur të Gjykatës Gresa-Caka Nimani, kryesuese të kolegjit për rastin KI91/21.
14. Më 8 qershor 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
15. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 20 janar 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Nga shkresat e lëndës rezulton që, më 27 prill 2018, Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) kishte ngritur aktakuzë [PP/I. nr. 25/2017] kundër parashtruesit të kërkesës dhe personave me inicialet D.H, D.L, M.M, E.H, për shkak të veprës penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve, substanca psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 si bashkëkryes lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK). Ndaj parashtruesit të kërkesës ishte ngritur aktakuzë edhe për veprën penale, mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK-së.
18. Më 19 qershor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 23/2018] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale “blerje, posedim, shpërndarje, dhe shitje të pa autorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 si bashkëkryerës lidhur me nenin 31 të KPRK-së”, si dhe për veprën penale “mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve

nga neni 374 par. 1 i KPRK-së”, ku për veprën e parë i shqiptoi dënim (i) me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burg, në të cilin iu llogarit edhe koha e kaluar në paraburgim dhe masën e arrestit shtëpiak; (ii) dënim me gjobë prej 1200 (njëmijë e dyqind) euro e cila do të paguhet në këste të barabarta pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe nëse i akuzuari refuzon ta paguaj gjobën ajo do ti shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do ti caktohet një ditë burgu; ndërsa për veprën e dytë i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) euro, i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse dënimi me gjobë nuk paguhet i njëjti zëvendësohet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 40 ditësh, ashtu që për çdo 20 euro do të vuajë 1 ditë burgu.

19. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Gjykatës së Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [PKR. nr. 23/2018] të 19 qershorit 2019.
20. Më 22 tetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 386/2019], vendosi që të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, vetëm sa i përket parashtruesit të kërkesës lidhur me dënimin, ashtu që ia merr si të vërtetuar dënimin e përcaktuar me burgim dhe gjobë, dhe në mbështetje të nenit 80 të KPRK-së, i shqipton dënim unik me gjobë në lartësi prej 2000 (dy mijë) euro, të cilin dënim parashtruesi ishte i obliguar që ta paguaj në kohëzgjatje prej 15 ditësh, enë rast se i njëjti nuk e paguan atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim duke i llogaritur çdo ditë burgimi me 20 euro të gjobës.
21. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, me propozimin që kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimet e kontestuar të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.
22. Më 18 dhjetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML. nr. 133/2020] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me nenin 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
24. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se *“Ne këtë çështje fillimisht bëhet fjalë për një aktakuzë e që për pasojë ka rezultuar me një Aktgjykim krejtësisht të pa qëndrueshme, me mangësi formale dhe*

procedurale evidente, gabime, mangësi te arsyeve, te provave dhe me pretendime të pa qëndrueshme. Gjykata, Prokurorit të çështjes i ka kthyer aktakuzën lëndore për shkak të parregullsive. Mirëpo, Prokurori i çështjes ka ngritur aktakuze të re. Aktakuza e parë kishte shenjë PP/I. nr. 25/2017 dt. 27.04.2018 e paraqitur nga Kryeprokurorja e atëhershme z/ja SH.B dhe aktakuza e dytë PP/1. nr. 03.07.2018, për te njëjtën çështje, nga Prokurori për Krime të rënda Z. A.U. Është cenuar parimi Ne bis in idem. Ky veprim është proceduralisht krejtësisht i pa lejuar”.

25. Tutje parashtruesi pretendon shkelje të neneve 132 dhe 257 i KPPRK-së, për arsye se siç thekson ai: *“Përkundër faktit që nga deponimet e të gjithë dëshmitarëve gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk u vërtetua asgjë, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar, pranon hapur se nga dëshmitë e tyre në atë shqyrtim nuk është vërtetuar asgjë, mirëpo thirret në deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në procedurë hetimore”.* Lidhur me këtë ai pretendon se gjykatës gjate shqyrtimit gjyqësor, i është tërhequr vërejtja se procedimi i këtyre dëshmitarëve në procedurën hetimore ishte kundërligjor. Sipas parashtruesit të kërkesës procedimi i dëshmitarëve nga gjykata me vrojtim të drejtpërdrejtë ka për qëllim krijimin e bindjes se gjykatës dhe opinionit te gjer lidhur me veprimet eventuale të të akuzuarve për veprat penale te cilat iu vihen në barrë. Deklarata e dhëna gjatë procedurës hetimore sipas tij janë marrë në kundërshtim të plotë me parimet e së drejtës, pasi që atij i është pamundësuar marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe është mohuar parimi i kontradiktoritetit, me te cilën rast është cenuar neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës. Lidhur me këtë parashtruesi i kërkesës iu referohet rastit të Gjykatës KI14/18.
26. Pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës e lidh edhe me mos arsyetimin e vendimeve nga ana e gjykatave të rregullta. Lidhur me këtë ai thekson se *“Përkundër faktit që këto pretendime te cituara më lartë janë parashtruar edhe në ankesë kundër aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë dhe në kërkesën për mbroje te ligjshmërisë nuk i ka trajtuar fare se a janë të qëndrueshme ato pretendime ankimore, nuk ka dhënë arsye bindëse se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Pra gjykata e rregullta thjeshtë dhe në mënyrë tërësisht gjeneralë ka aprovuar vlerësimin e gabuar të gjykatës së shkallës së parë lidhur me vlerësimin e rrethanave rënduese në rastin e shqiptimit të sanksionit penal. Aktgjykimi i Gjykatës se Apelit nuk përmban arsyetimin e duhur”.* Ai i referohet aktgjykimit të Gjykatës KI97/19, ku thekson se gjykata në këtë aktgjykim ka konstatuar nevojën e arsyetimit të pretendimeve ankimore.
27. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 33 të Kushtetutës parashtruesi i kërkesës tutje thekson *“për faktin se ndaj këtu te dënuarit, ashpërsia e dënimit dhe lartësia e tij është si pasojë ekskluzive e përcaktimit të kriterit që i njëjti ka qenë recidivist, po që dënimet e shqiptuara më parë, konform ligjit (Kodit Penal te Kosovës) nuk prodhojnë pasoja juridike. Fakti që dënimi me gjobë dhe me kusht nuk parashihet se prodhojnë pasoja juridike, konsiderojmë që nuk është dashur të merren si rrethanë rënduese siç kanë vlerësuar gjykatat e rregullta”.*

28. Sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës përveç përmendjes së këtyre neneve nuk shtjellon më tutje se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij të garantuara përmes këtyre neneve të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.
29. Në fund parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 3, 24, 31, 33 të Kushtetutës dhe nenit 1 të protokollit 1 dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML. nr. 133/2020] të 18 dhjetorit 2020, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 386/19] të 22 tetorit 2019, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [PKR. 23/2018] të 19 qershorit 2019.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

33. Sa i përket plotësimin të këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të tij; ka cituar një akt të autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 133/2020, të 18 dhjetorit 2020; ka theksuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur; dhe ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara me ligj.

34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton se:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

35. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtrues *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar

në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284; shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).

37. Në këtë kontekst, përkatësisht, vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28 si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 39).
38. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me (i) nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, (ii) nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, dhe nën (iii) shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës si dhe nenin 1 të Protokollit 1 [Mbrotjtja e pronës] së KEDNJ-së. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë individualisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

(i) Përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së

39. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të GJEDNJ-së, kanë të bëjnë me mënyrën me të cilën gjykatat e rregullta kanë interpretuar KPPK në rastin e tij. Lidhur me këtë, ai thekson se Gjykata Themelore aktakuzën e parë PP/I. nr. 25/2017 të 27.04.2018 e ka kthyer për shkak të parregullsive dhe se pas kësaj paditësi në rastin kontestues ka ngritur aktakuzë të re me numër PP/1. nr. 07/03/2018 dhe kështu ka kryer një vepër tërësisht të palejueshme proceduralisht, duke shkelur kështu parimin *Ne bis in idem*. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore ka interpretuar gabimisht deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor përkundër dispozitave të KPPK-së, përkatësisht nenit 132 në lidhje me nenin 257, përkitazi me mënyrën se si gjykatat e rregullta e kanë përdorur deklaratën e dëshmitarit., përkatësisht të njëjtën e kanë marrë në mënyrë të kundërligjshme. Kjo shkelje e procedurës nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Apelit dhe as nga Gjykata Supreme. Për më tepër, në lidhje me këtë shkelje, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykatat e rregullta, thjesht dhe në mënyrë shumë të përgjithshme, kanë aprovuar vlerësimin e gabuar të gjykatës së shkallës së parë lidhur me vlerësimin e rrethanave rënduese me rastin e shqiptimit të sanksionit penal.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues i kërkesës ka qenë fajtor për

kryerjen e një veprë penale apo jo. Gjykata nuk ka juridiksion as të vlerësojë nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe as të vlerësojë nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kishin prova të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës (Shih: në këtë kontekst dhe, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, Parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

41. Gjykata thekson qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike ose ligjore (ligjshmëria) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme ose nga një gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç në masën që ato gabime mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata më tej rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e “*shkallës së katërt*” në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtetë, roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).
42. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të duhur dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik, dhe shih rastin e Gjykatës KI110/19, cituar më lart, paragrafi 41).
43. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore e ktheu aktakuzën e parë për shkak të parregullsive dhe se ushtruesi i detyrës së Prokurorit të Shtetit më pas ngriti një aktakuzë të re, duke kryer kështu një veprë të palejueshme procedurale dhe duke shkelur parimin *Ne bis in idem*. Gjykata vëren se lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit arsyetoi,

*“[...] Nga kjo për Gjykatën e Apelit rezulton se nuk plotësohet elementi kryesor ekzistimin e vendimit të formës së prerë në procedurën penale që akuzohen të akuzuarit, pra kemi një aktgjykim që është goditur me ankesë nga vet mbrojtja. Sa i përket faktit të kthimit në përmirësim të akuzës ajo çështje është e rregulluar me dispozitat e nenit 442, ku kjo dispozitë i jep kompetencë gjykatës që kur aktakuza është ndërtuar në formën e tillë që pamundëson veprimin e gjykatës në procedurë të mëtejme duhet ti kthehet prokurorit~ par kjo në asnjë mënyrë nuk përben çështje të gjykuar për të mundur të aplikohet parimi *ne bis in idem*, ky parim mbron të drejtën e të akuzuarit për të mos u persekutuar në procedura penale pasi që një çështje merr zgjidhje gjyqësore lidhur me përgjegjësinë penale të tij, por komunikimi dhe kthimi i aktit akuzues nuk mund të konsiderohet si çështje*”

e gjykuar, dhe vet fakti se prokuroria ka sjellur një aktakuzë me numër të njëjtë por me datë të re, rezulton se kemi të bëjmë vetëm me një aktakuzë për çështjen e njëjtë ndaj të akuzuarve. Për këto arsye, Gjykata e Apelit konsideron se pretendimi se është cenuar parimi ne bis in idem është i pabazuar...”

44. Gjykata Supreme gjithashtu iu përgjigj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës më lart, *“janë të pabazuara pretendimet se në rastin konkret është shkelur parimi “ne bis in idem”. Nga shkresat e lëndës rezulton se akuza ndaj të dënuarve në këtë çështje juridiko penale është ngritë më 27.04.2018 për veprën penale nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK. Para caktimit të shqyrtimit fillestar gjyqtari i çështjes ia kthen në përmirësim prokurorit akuzën për faktin se në përshkrimin faktik të veprimeve inkriminuese nuk ishin të ndara veprimet e tyre. Prokurori e përmirëson akuzën dhe e dorëzon në gjykatë më 3.07.2018, mirëpo edhe nga akuza e përmirësuar del se të dënuarit akuzohen për veprën pe ale të njëjtë prandaj pa bazë pretendohet se të dënuarit janë akuzuar me rëndë dhe është shkelur parimi “ne bis in idem”. Sipas këtij parimi (neni 4 i KPP) askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. Bazuar në këtë parim dhe faktin se gjykata e shkallës së parë e ka kthyer vetëm në përmirësim akuzën, për vetë gjykatën nuk janë të qarta pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim; kurse janë krejtësisht të pabazuara pretendimet e tij se gjykata e shkallës së dytë lidhur me këtë pretendim ka heshtur”.*
45. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme pretendoi se më rastin e tij kishte ardhur deri te shkelja procedurës, për shkak se arsyetimi i gjykatave të instancave më të ulëta ishte i bazuar në prova të pranueshme siç kërkohet me nenin 132 dhe nenin 257 të KPPK-së. Në arsyetimin e saj në lidhje me pretendimet përkitazi me interpretimin e gabuar të provave, Gjykata Supreme arsyetoi, ndër të tjera, se: *“pavarësisht faktit se me rastin e deklarimit të dëshmitarëve në hetime nuk janë njoftuar mbrojtësit dhe të dënuarit konform dispozitës së lartcekur dëshmitë e tyre e të dhëna në hetime nuk janë prova të papranueshme ashtu siç pa bazë pretendon mbrojtësi, ngase dëshmitë e tyre nuk janë përdor si provë e drejtpërdrejtë në shqyrtimin gjyqësor ngase që të gjithë janë dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor dhe janë marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë edhe përkitazi me ndryshimin e deklaratave të tyre, ndërsa, është në diskrecion të gjykatës se cilës deklaratë do t'ia falë besimin dhe në këtë drejtim gjykata nuk është e lidhur me rregulla të posaçme formale. Pra, pretendimet e mbrojtësit do të ishin të bazuara sikurse dëshmitaret në këtë çështje të mos dëgjoheshin në shqyrtimin gjyqësor dhe gjykata t'i përdorte deklaratat e tyre në hetime në shqyrtimin gjyqësor duke i administruar si prova të drejtpërdrejta. Pastaj, nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë indikacion se me rastin e dëgjimit të dëshmitarëve në polici ndaj tyre është përdor dhunë, kurse nga shkresat e lëndës del se të gjithë i kanë nënshkruar deklaratat e tyre.. [...], dëshmitë e dëshmitarëve nuk janë e vetmja provë në këtë çështje. Ngase aktgjykimet e kundërshtuara mbështeten edhe në prova tjera si raportet e vëzhgimit datë 22.04.2017 e 19.05.2017, transkriptët e bisedave telefonike, vëzhgimet me audio dhe video incizimet*

dhe provat tjera të cekura më detajisht në aktgjykimin e shkallës së parë. Kurse, dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në polici dhe hetime provohen edhe nga transkriptet e bisedave telefonike në mes të dëshmitarëve dhe të dënuarve.”

46. Prandaj, në bazë të të lartcekurave, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë përmbushur detyrimin e tyre nga neni 31 paragrafi 1 i Kushtetutës dhe neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së, prandaj edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me vendimet e kontestuarra është shkelur e drejta për gjykim të drejtë në atë segment janë të pabazuara.
47. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit të tij, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih: *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42, si dhe rasti KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).
48. Prandaj, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal, si dhe ligjit të procedurës penale, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata konstaton gjithashtu se procedurat në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih: Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55; shih gjithashtu: në lidhje me këtë, ndër të tjera, rastin KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
49. Gjykata rikujton se vetëm fakti që parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta ose përmendja e thjeshtë e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ngritur një çështje për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 61; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 59).
50. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
51. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi

të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Në lidhje me pretendimin për shkeljen e të drejtave të të akuzuarit, e drejtë e garantuar me nenin 33 të Kushtetutës

52. Sa i përket shkeljes së nenit 33 të Kushtetutës, përkatësisht shkeljes së të drejtave të të akuzuarit, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës pretendon, *“për faktin se ndaj këtu te dënuarit, ashpërsia e dënimit dhe lartësia e tij është si pasojë ekskluzive e përcaktimit të kriterit që i njëjti ka qenë recidivist, po që dënimet e shqiptuara më parë, konform ligjit (Kodit Penal të Kosovës) nuk prodhojnë pasoja juridike. Fakti që dënimi me gjobë dhe me kusht nuk parashihet se prodhojnë pasoja juridike, konsiderojmë që nuk është dashur të merren si rrethanë rënduese siç kanë vlerësuar gjykatat e rregullta”*.
53. Edhe pse parashtruesi i kërkesës e thekson këtë pretendim si shkelje të nenit 33 të Kushtetutës, Gjykata vëren se të drejtat në të cilat thirret parashtruesi në thelb janë të drejta të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës.
54. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se nuk do të merret në mënyrë të veçantë me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, për shkak të faktit se lidhur me procedurën e provave, gjendjes faktike dhe çështjes së caktimit të dënimit, Gjykata u mor me këtë pjesë të pretendimit në arsyetimin e pretendimit në lidhje me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

(iii) Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së

55. Sa i përket shkeljes së të drejtave të garantuara me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) e pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”* kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim) nr. 4241/03 i 31 majit 2005*, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim) nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008*);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga

dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vet Gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 42)

56. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës thjesht ka përmendur shkeljen e neneve 3, dhe 24 të Kushtetutës, si dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, megjithatë, parashtruesi më tej në kërkesë nuk jep një arsytim më të detajuar se si janë shkelur këto nene.
57. Sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse të Kushtetutës, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81, KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52, KI04/21 cituar më lart, paragrafët 38- 39).
58. Prandaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato janë shkelur. Prandaj, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

59. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 24, 31 dhe 33 të Kushtetutës, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si qartazi të pabazuara, pasi këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë (i) së pretendimeve „*të shkallës së katërt*“; dhe kategorisë (iii) së pretendimeve „*të pambështetura ose të paarsyetuara*“. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 janar 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani